

Statuti “Shoqata Humanitare Letovica”

Neni 1

Shoqata Humanitare Fondi i Letovicës në Kuvendin e Përgjithshëm të mbajtur më datën 03.03.2024 në Reinach AG të Zvicrës, ka vendosë që të pranojë këtë Statut të ndryshuar dhe të plotësuar nga Statuti i mëparshëm që ishte në funksion që nga themelimi i Shoqatës me datën 24.04.2016. si dhe vendosi që Emri si “Shoqata Humanitare Fondi i Letovicës” të shkurtohet dhe të zëvendësohet me Emrin “Shoqata Humanitare Letovica”.

Neni 2

Emri dhe selia

Shoqata Humanitare Letovica (SH.H.L)

Selia Ostermundigen Kanton Bern

Neni 3

Veprimtaria e shoqatës është e bazuar në nenin 60 ZGB në vijim të Kodit Civil të Konfederatës Zvicërene.

Në këtë Statut rregullohen të drejtat, obligimet, veprimtaria dhe organizimi i Shoqatës.

Dhe kohëzgjatja e veprimtarisë së "SH.L" është e pakufizuar .

Neni 4

Shoqata posedon: Vulën, Logon dhe Xhirollogarinë Bankare, (nuk përjashtohet mundësia që në të ardhmen të ketë edhe flamurin e saj).

Valutë e vetme zyrtare e Shoqatës Humanitare Letovica është Franga Zvicërene (**CHF**).

Pagesat që bëhen me valuta tjera, ato konvertohen në mënyrë automatike në (**CHF**) nga Banka sipas kursit aktual të ditës.

Neni 5

Mjetet Financiare

1. Shoqata financohet nga kontributet vjetore të anëtarëve
2. Nga Fondi për reklamat e sponzorëve në webfaqen e Shoqatës
3. Nga aktivitetet kulturore dhe sportive
4. Nga donacione të ndryshme.

Neni 6

Mbikëqyrja dhe kontrolli i xhirollogarisë

Mbikëqyrjen e punëve financiare rrjedhimisht e kryen Kryesia, kurse kontrollimin dhe miratimin e llogaris përfundimtare e bën Kuvendi njëherë në vit.

Neni 7

Të gjitha veprimet (transakcionet) Bankare të "SH.H.L" bëhen me aprovimin e Kryetarit, Sekretarit dhe të Arkëtarit, në mungesë të ndonjërit prej tyre, atëherë zëvendësohet me një Anëtarë të Kryesisë.

Neni 8

Synimet e Shoqatës

Shoqata Letovica në Zvicër është organizim i krijuar me vetë vullnetin e lirë të bashkatdhetarëve nga Letovica që jetojnë dhe punojnë në Zvicër, Evropë dhe në vende tjera të botës.

Neni 9

SH.H.L është Shoqatë joqeveritare, jopartiake, jopolitike dhe jofetare, me karakter social, humanitar dhe kulturor, që mbështetet në parimet Demokratike Kushtetuese, mbi ligjet e Konfederatës Zvicëране dhe Normat Ndërkombëtare të së Drejtës.

Neni 10

Organizon takime të rregullta me mërgimtarët e fshatit Letovicë, me synim bashkimin e mërgimtarëve, njoftimin e të rinjve mes veti, informimin me rrjedhat në vendlindje, integrimin e anëtarëve të shoqatës në shoqërinë Zvicëране, përmes aktiviteteve kulturore, sportive, humanitare, arsimore etj, në përputhje me Statutin e Shoqatës.

Neni 11

Objektivat e Shoqatës

Shoqata ka për qëllim mbështetjen financiare dhe materiale të fshatit Letovicë.

Ndihmon familjet në kushte të vështira ekonomike dhe shëndetësore, jetimët si dhe personat me aftësi të kufizuara. Ndihmon projektet që realizohen në fshat, si në infrastrukturë, ruajtjen dhe pastërtinë e ambientit në përmirësimin e jetës së përgjithshme të banorëve dhe në ruajtjen e mjedisit për brezat e ardhshëm.

Neni 12

Organet e SH.L. janë:

1. Këshilli i Përgjithshëm
2. Kryesia e Shoqatës

Neni 13

Këshilli i Përgjithshëm është organi më i lartë i SH.H.L dhe është i përbërë nga Të gjithë bashkëvendasit e fshatit Letovicë që janë të anëtarësuar në Shoqatë.

Neni 14

Këshilli i Përgjithshëm mblidhet në çdo dy vite. Në të gjitha rastet thirret nga Kryesia e SH.L ose me kërkesë të nënshkruar nga shumica e Anëtarëve të Këshillit të Përgjithshëm.

Neni 15

Këshilli i Përgjithshëm ka këto kompetenca:

1. Modifikimi, plotësimi apo ndryshimi i Statutit,
2. Aprovimi i rregulloreve të ndryshme,
3. Zgjedhë Kryesinë,
4. Zgjedhë dhe shkarkon Anëtarët e Kryesisë.
5. Vendos mbi kuotën financiare të subjekteve,
6. Vendos mbi shpërbërjen e SH.L.

Nenin 16

Kryesia përbëhet nga:

Kryetari, Sekretari dhe Arkëtari

Dhe nga 1 Këshilltar i lagjeve përkatëse të fshatit.

Neni 17

Kryesia mblidhet sa herë që ka nevojë me ftesë të Bordit të Kryesisë.

Kryesia e SH.H.L është e autorizuar ti marrë të gjitha veprimet që janë në pajtim me qëllimet e krijimit dhe detyrat tjera që mandatohen në Kuvend .

Neni 18

Kryesia ka këto kompetenca:

1. Përfaqëson Shoqatën në raport me të tjerët,
2. Paraqet raportet vjetore para Kuvendit,
3. Në rast nevojë i propozon Kuvendit ndryshimin apo plotësimin e Statutit,
4. Përpilon rregulloren e punës dhe plan-programin e veprimit,
5. Administron Shoqatën, regjistrimin e Kontabilitetit dhe ruajtjen e dëshmive,
6. Koordinon veprimet me Shoqata tjera,
7. Përpilon kalendarin vjetor.

Neni 19

Këshilltarët e Kryesisë kanë këto kompetenca:

1. Kujdesen për mbarëvajtjen e Shoqatës,
2. Përfaqësojnë interesat e Lagjes përkatëse,
3. Janë përgjegjës për grumbullimin e mjeteve materiale dhe identifikimin e Anëtarëve të rinj për lagjen që e përfaqësojnë,
4. Marrin pjesë në zgjedhjen e Kryesisë,
5. Komunikojnë drejtpërdrejt me Kryesinë dhe anasjelltas me Anëtarët e Lagjes përkatëse,
6. Marrin pjesë në vendim marrje në çdo projekt.

Neni 20

Anëtarët e kryesisë SH.L janë të obliguar të marrin pjesë në mbledhjet e kryesisë. Për mos pjesëmarrje në mbledhje tri herë pa arsye, mundë të zëvendësohet me një anëtarë tjetër përkatës.

Neni 21

Anëtarët e kryesisë janë vullnetarë dhe në parim nuk paguhen për angazhimin e tyre nga fondet e SH.L. Ata sipas nevojës me vendim të këshillit drejtues mundë të kompensohen për shpenzimet e tyre në bazë të llogarive të dëshmuara.

Neni 22

Anëtarësia

Në Shoqatë mund të anëtarësohen të gjithë personat e moshës madhore pa dallim gjinie, të cilët kanë aftësi për të vepruar dhe pranojnë dhe respektojnë qëllimin e Shoqatës dhe po ashtu janë të gatshëm ti promovojnë vlerat e saj.

Neni 23

Çdo anëtar i Shoqatës është i obliguar të paguaj anëtarësinë vjetore në mënyrë të rregullt.

Kuota minimale e Anëtarësisë në vit është CHF 120 ose Euro 100.-

Neni 24

Të drejtat e anëtarit:

1. Çdo anëtar është i detyruar të respektoj Statutin dhe vendimet Shoqatës
2. Çdo anëtar i Shoqatës ka të drejtën e fjalës dhe shprehjes së lirë të mendimit.
3. Çdo anëtar ka të drejtën e votës.
4. Çdo anëtar ka të drejtë të propozoj ndonjë ide të caktuar në të mirë të Shoqatës.
5. Çdo anëtar i ka të drejtë të zgjedhë ose të zgjidhet në organet e saja drejtuese.
6. Çdo anëtar ka të drejtë të jetë bartës i aktiviteteve të ndryshme të Shoqatës.

Neni 25

Obligimet e anëtarit:

1. Çdo anëtar i SH.L është i obliguar të mos e keqpërdor emrin e saj dhe cilësinë e anëtarit për bindjet dhe aktivitetet e tij, që nuk kanë të bëjnë me qëllimet e Shoqatës.
2. Çdo anëtar është i obliguar të paguaj Anëtarësinë vjetore në mënyrë të rregullt e cila është e caktuar nga Këshilli i Përgjithshëm.
3. Çdo anëtar duhet të respektoj programin e Shoqatës dhe të kontribuoj në realizimin e tij në rast të marrjes së ndonjë përgjegjësie.
4. Çdo anëtar i Kryesisë, i Këshillit të Përgjithshëm, apo të grupeve punuese, i kryejnë detyrat e tyre në mënyrë vullnetare.

Neni 26

Dorëheqja nga Shoqata duhet t'i adresohet Kryesisë me shkrim. Me dorëheqjen nga Shoqata, fshihen të gjitha të drejtat në Thesarin e Shoqatës.

Neni 27

Kur një Anëtar dëmton interesin apo imazhin e krijuar të Shoqatës gjatë bisedave në shoqëri apo komenteve nëpër rrjetet sociale, ai mund të largohet nga Shoqata me vendim të Kryesisë, nëse Kryesia e sheh të arsyeshëm këtë largim.

Për largimin e një Anëtari nga Shoqata, Kryesia nuk është e obliguar t'i arsyetohet të larguarit.

Neni 28

Shpërbërja e Shoqatës Letovica mundë të bëhet vetëm nga Këshilli i Përgjithshëm me 2/3 e votave të përgjithshme të Këshillit. Në të njëjtin Këshill duhet të emërohen dy ekzekutues të vendimit që të zbatohen veprimet e duhura. Në rast të shpërbërjes mjetet të cilat i disponon Shoqata i kalon një institucioni me interes publik. Në asnjë rast në këto mjete nuk mund ti kthehen donatorit, as në tërësi as pjesërisht.

Neni 29

Ky Statut u miratua nga Këshilli i Përgjithshëm në mbledhjen e mbajtur më datën 03.03.2024 në Reinach AG të Zvicrës, dhe me këtë datë hynë në kohësisht në fuqi.

Kryetari

Sekretari

Arkëtari

.....

.....

.....